

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

22.04.2021

Ora 10:34

RENDI I DITËS

Shorti për caktimin e Relatorit të Kërkesave Ankimore nr.15, nr.16, nr.17.

PJESËMARRJA :

Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, pranë KQZ-së janë paraqitur 3 Kërkesa Ankimore. Kërkesa Ankimore nr.15, Kërkesa Ankimore nr.16 dhe Kërkesa Ankimore nr.17. Kërkesa Ankimore nr.15 me ankues subjektin Partia Bindja Demokratike, objekti i kundërshtimit është Vendimi nr.225 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve datë 20.04.2021 të KZAZ-së nr.30 për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor. Gjithashu është paraqitur po nga Partia Bindja Demokratike, Kërkesa Ankimore nr.16, objekti i kundërshtimit është Vendimi nr.1 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve datë 21.04.2021 të KZAZ-së nr.33 për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor. Kërkesa Ankimore nr.17, ka ankues zotin Kastriot Gura, Kryetari i Bashkisë Librazhd i cili kundërshton Vendimin nr.235 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve datë 14.04.2021. Sipas nenit 14 të Rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit, për shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura pranë KQZ-së. Procedura e shortit është e njëjtë si ka qenë dhe më parë. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në 3 nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “Kërkesë Ankimore nr.15”, “Kërkesë Ankimore nr.16” dhe “Kërkesë Ankimore nr.17”. Atëherë 5 shiritat janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë të tejdukshme. Një përfaqësues i Administratës i vendos shiritat nëpër gogla dhe

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

bën përzierjen e tyre. Sipas nenit 14 të rregullatores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi gogllën, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, sipas rendit alfabetik rritës, në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it.

Për Z. E. Lako: Tërheq gogllën 1 - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.17.

Për Z. E. Çefa: Tërheq gogllën 2 - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. I. Rusmali: Tërheq gogllën 3 - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.15.

Për Z. K. Bele: Tërheq gogllën 4 - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. L. Braho: Tërheq gogllën 5 - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.16.

Në përfundim të rezultatit të shortit Administrata e KQZ-së bën publik rezultatit nga i cili :

Zoti I. Rusmali është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.15,

Zoti L. Braho është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.16,

Zoti E. Lako është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.17.

Procedurën e shortit e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

22.04.2021

Ora 17:54

RENDI I DITËS

Shorti për caktimin e relatorit të kërkesave ankimore nr.18, nr.19, nr.20, nr.21,
nr.22.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj

Z. Y. Merkaj: Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë depozituar 5 kërkesa ankimore, kërkesa ankimore 18, 19, 20, 21, dhe 22.

Në bazë të nenit 14 të Rregullores së Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për çdo kërkesë ankimore do të hidhet shorti. Procedura e shortit është e tillë. Në pesë shirita letre të bardhë vendosim kërkesat ankimore, futen në gogla me ngjyrë, formë dhe me peshë të njëjtë dhe anëtarët e KAS-it sipas rendit alfabetik rritës tërheqin goglat. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Kemi 5 shirita letre në to janë të shkruar respektivisht: Kërkesa ankimore nr.18, Kërkesa ankimore nr.19, Kërkesa Ankimore nr.20, Kërkesa Ankimore nr.21 dhe Kërkesa Ankimore nr.22.

I hedhim dhe i trazojmë në enën transparente. Sipas rendit alfabetik rritës tërhiqen goglat nga anëtarët e KAS-it.

- Zoti Ervin Lako, tërheq i pari goglën përkatëse, autorizon përfaqësuesin e KQZ-së për tërheqjen e goglës. Atëherë, Kërkesa ankimore nr.21 do të relatohet nga zoti Ervin Lako, subjekti ankues Partia Aleanca Demokracia e Re ndaj KZAZ nr.30, për refuzimin e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor.


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

- Zoti Elvis Çefa, autorizon përfaqësuesin e KQZ-së. Relatori i Kërkesës Ankimore nr.18 është zoti Elvis Çefa, subjekti ankues është Lëvizja për Ndryshim, kërkon shfuqizimin e vendimit të KZAZ-së nr.52 për refuzimin e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor.
- Zoti Ilirjan Rusmali, autorizohet përfaqësuesi i KQZ-së të tërheqë goglën. Kërkesa Ankimore nr.20, me relatues zotin Ilirjan Rusmali, subjekti ankues Partia Aleanca Demokracia e Re. Kundërshton vendimin e KZAZ-së nr.41 për refuzimin e listës së vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor.
- Zoti Koli Bele, autorizon përfaqësuesin e KQZ-së për të tërhequr goglën. Atëherë, relator i Kërkesës Ankimore nr.22 është zoti Koli Bele, subjekti ankues Partia Aleanca Demokracia e Re, kundërshton vendimin e KZAZ-së nr.27 për refuzimin e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor.
- Zoti Ledio Braho, kërkesa ankimore e fundit është ajo me nr.19. Subjekti ankues është Partia Aleanca Demokracia e Re, kundërshton vendimin e KZAZ-së nr.33 të Qarkut Tiranë për mospranimin e listave të vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**22.04.2021
Ora 17:32**

RENDI I DITËS

**Projektakti “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.15 me subjekt ankues
Partia Bindja Demokratike”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:**

Z. I. Rusmali: Shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 15, me subjekt Partinë Bindja Demokratike. Prezent është Sekretari i Përgjithshëm me administratën e KQZ-së. Subjekti nuk ka përfaqësues në këtë seancë, por ne mund ta zhvillojmë gjithsesi seancën.

Z. Y. Merkaj: Ka njoftuar që të zhvillohet në mungesë të tij.

Z. I. Rusmali: Dakord! Mirë, atëherë mund të na prezantoni shkurtimisht kërkesën.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 21.04.2021, është paraqitur një kërkesë ankimore me ankues Partia Bindja Demokratike, me objekt ankimi “Kundërshtimi i vendimit të KZAZ-së nr.30, nr.225, datë 20.04.2021, “Për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike”. Në arsyetimin e ankimit, pretendojnë se i ka kthyer padrejtësisht dhe nuk ka sjellë asnjë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

argument KZAZ-ja, për refuzimin e vëzhguesve të subjektit politik Bindja Demokratike. Shorti ka përcaktuar relator zotin Rusmali.

Z. I. Rusmali: Dakord! Elementët formalë, janë në rregull?

Z. Y. Merkaç: Po kërkesa ankimore është bërë sipas formës dhe standartit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ankimohet vendimi i KZAZ-së, që është kompetencë e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si dhe legjitimohet subjekti zgjedhor pasi janë prekur interesat e tij të ligjshëm.

Z. I. Rusmali: Ndonjë çështje nga kolegët për ta trajtuar për këtë? Nuk ka, ndonjë pyetje?

Z. K. Bele: Po më fal, kisha unë një pyetje! Ylli, po shoh praktikën e Kërkesës Ankimore nr.15, pashë në vazhdim dhe Kërkesën Ankimore nr.16. Thjesht, për ta kuptuar unë, se po lexoj vendimin e KZAZ-së, po e shoh këtë më shumë si për të ndihmuar e për të kuptuar dhe shoh që këtu vetëm votohet. Këta si praktikë pune nuk bëjnë një rresht që domethënë kur e refuzojnë, të thuhet “refuzohet se nuk na pëlqen, se është i..”.

Z. Y. Merkaç: Si praktikë duhet ta kishin bërë një arsyetim, megjithatë nuk e kanë bërë.

Z. K. Bele: Në praktikë të thuash që refuzohet pa thënë qoftë se këta nuk e dinë se kur është afati, ose janë të mitur që nuk plotësojnë kushtin, ose nuk janë shtetas shqiptarë por janë nazistë..,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

Z. E. Çefa: Tek njëra nuk thotë, tek tjetra e thotë.

Z. K. Bele: Po ku e thotë? Unë shoh këtu pasi shqyrtoi nuk i gjen ato në përputhje me nenin 6, ndoshta neni flet për afatin, kundër këtij vendimi tek 15..

Z. Y. Merkaj: Neni 6 çfarë thotë?

Z. K. Bele: Dakord, e shohim dhe nenin 6 por mund të jetë dhe gabimi im se pashë 16, por ke 16 kam vetëm këtë letër. Pro, kundër dhe asgjë tjetër. Pa paragjykuar se çfarë do të vendosim ne këtu, por duhen orientuar këta se janë zyrtarë shteti, nuk janë...

Z. L. Braho: Neni 6.. fillon afati mesa shoh unë.

Z. K. Bele: Se nuk e gjeta kodin, nuk e kam me vete.


Z. I. Rusmali: Dakord, por biem dakord ta kalojmë për shqyrtim?

Paneli i KAS-it: Dakord!

Z. I. Rusmali: Dakord! Këto pyetje që kemi si do ti sqarojmë? Do t'i sqaroni ju apo duke komunikuar me ta apo duhet t'i thërrasim ne ata?

Z. Y. Merkaj: Në fakt unë kam patur një komunikim edhe me KZAZ-në edhe me përfaqësuesit e Partisë Bindja Demokratike, kur kanë qenë në KZAZ, kur kanë çuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

listën e vëzhguesve dhe ata nuk i kanë pranuar me arsyen, pretendimin se janë jashtë afatit 15 ditor para ditës së zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Dakord! Unë kisha dhe disa pyetje, për eventualisht për sekretarin e KZAZ-së. Unë kënaqem edhe nëqoftëse ju ja përcillni dhe na sillni përgjigjet e tij, nëqoftëse kolegët duan që ta kenë këtu prezënt sekretarin pastaj është histori tjetër.

Z. E. Çefa: Nuk do mundemi dot dhe në rast...

Z. I. Rusmali: Po pra. Atëherë, pyetjet që kam unë, është në fakt, për të gjitha rastet, por meqë është ky rasti i parë po e bëj për rastin e parë. Sa subjekte zgjedhore kanë akredituar ata, si ua kanë akredituar vëzhguesit ata si KZAZ dhe nëse ka subjekte që nuk i kanë akredituar cilat janë këto subjekte? Për shkak se mund të mos sqarohet nga pyetja e parë, po bëj një pyetje të dytë. A ka subjekte të tjera që u është rrëzuar kërkesa për akreditim vëzhguesish, nëse po, cilat janë këta subjekte? Pyetja e tretë është: A ka komunikuar KZAZ-ja me subjektin ankues përpara datës 10 prill, për ta informuar se në këtë datë skadonte afati për paraqitjen e kërkesës për akreditim? Nuk ka rëndësi, nuk kam nevojë të më bëjnë teori juridike, më thonë kanë patur një komunikim të tillë, domethënë të më shpjegojnë nëse ekziston fakti apo jo? Kanë komunikuar apo jo? Po, jo? Kaq! Një pyetje që ndoshta ka lidhje me metodën e punës, midis refuzimit të kërkesës, rrëzimit të kërkesës dhe miratimit të saj kush është diferenca në ngarkesën e punës për KZAZ-në? Domethënë do t'i kërkojë më shumë punë miratimi atyre apo, domethënë që të kemi idenë se..., dakord!

Z. K. Bele: Doja të shtoja edhe unë një pyetje!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*


Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. K. Bele: Doja të shtoja edhe unë një pyetje që në vendimarrjen që mund ta nxjerrë administrata këtu, nga eksperiencia nga njohuritë, si ka vepruar KQZ-ja në zgjedhjet e fundit ndaj këtyre rasteve. Pra, kur ka patur refuzim të akreditimit nga KZAZ-të, në zgjedhjet vendore apo të përgjithshme, në zgjedhjet e fundit, e parafundit, a janë pranuar këto kërkesa. Pra, kush është praktika e vendimarrjes në këtë institucion, na ndihmon ne, mendoj unë në vendimin tonë, të paktën mua.

Z. I. Rusmali: Dakord! Pyetje tjetër? Do të thotë e mbyllim këtë çështje këtu, Nesër në orën 11:00 është seanca për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.15.

Vendimi nr.26

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.16 me subjekt
ankues Partia Bindja Demokratike".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:**

Z. L. Braho: Atëherë, Partia Bindja Demokratike, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Kërkesën Ankimore numër 16, e cila është regjistruar në datën 21.04.2021, në orën 16:10. Pas hedhjes së shortit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, relatimi për këtë çështje i ka rënë anëtarit Ledio Braho. Partia Bindja Demokratike, ankimon vendimin nr.1 të KZAZ-së nr.33. Vendim i datës 21.04.2021, në lidhje me akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor Bindja Demokratike. Më konkretisht, në këtë vendim, KZAZ-ja nr. 33, ka vendosur të mos miratojë kërkesën e subjektit zgjedhor Bindja demokratike për akreditimin e vëzhguesve për vëzhgimin e procesit për zgjedhjet në kuvend, si arsye e tejkalimit të afatit të vendimeve të Komisionit Rregullator për miratimin e udhëzuesit. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje të KZAZ-së, Partia Bindja Demokratike ka depozituar ankimimin. Në këtë seancë shqyrtojmë pjesën e kompetencës së KAS-it, legjitimitimin e ankuesit dhe respektimin e afateve ligjore! Fjalën e ka administrata në lidhje me këto kritere!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

Z. Y. Merhaj: Kërkesa është paraqitur brenda afateve ligjore pasi ankimohet vendimi më datë 21.04.2021. Kërkesa ankimore është paraqitur brenda afatit tre ditor. Në lidhje me legjitimitetin, Partia Bindja Demokratike legjitimohet, sipas kësaj kërkesë, pasi i janë shkelur interesat e ligjshme për caktimin e vëzhguesve dhe i drejtohet me këtë kërkesë KAS-it, pasi është kompetent për shqyrtimin e këtyre vendimeve të marra nga KZAZ-të. Nga ana formale është paraqitur sipas standardit të formatit të miratuar nga KQZ-ja. Pra i përmbush të gjithë elementet e përmbajtjes, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit atëherë vendimi në lidhje me këtë çështje të kalohet për shqyrtim. Atëherë KAS-i vendosi të kalojë për shqyrtim Kërkesën Ankimore nr.16, të depozituar nga partia BD. Shqyrtimi administrativ do të kryhet në datë 23.04.2021, në orën 11:30. Seanca deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr.27

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**22.04.2021
Ora 17:46**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.17 me subjekt
ankues Zoti Kastriot Gurra, Kryetar i Bashkisë Librazhd".**

PJESËMARRJA :


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:**

Z. E. Lako: Fillojmë shqyrtimin e ankesës me nr.17 të subjektit ankues të Bashkisë Librazhd, me objekt kundërshtimin e vendimit nr.235, datë 14.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e denoncimit të parashikuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Vendimin nr.9 të Komisionit Rregullator dhe Udhëzimin nr.6 të KQZ-së, ndaj Bashkisë Librazhd. Relator jam unë, Ervin Lako sipas shortit të hedhur sot më 22.04.2021.

Atëherë nga administrata, dy fjalë rreth ankimit!

Z. Y. Merkaj: Pranë KQZ-së është paraqitur Kërkesa Ankimore nr.17, në datë 22.04.2021, në të cilën kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.235 datë 14.04.2021, ankues është Kastriot Gurra, Kryetar i Bashkisë Librazhd. Legjitimohet Kryetari i Bashkisë Librazhd për të paraqitur një kërkesë të tillë, kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka paraqitur masën e gjobës. I drejtohet Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve i cili është

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje! Në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në dispozitiv në pikën 5 thuhet “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së”. Data e shpalljes së vendimit është data 14.04.2021. Data e depozitimit të ankesës është data 22.04.2021, jashtë afatit tre ditor të paraqitur nga kërkuesi.

Z. E. Lako: Faleminderit! Ndonjë pyetje?

Z. I. Rusmali: Dihet kur kanë marrë dijani?

Z. Y. Merkaj: Më datë 16 kanë marrë dijani. Megjithatë data 14 është data e hyrjes në fuqi të vendimit. Këtë vendim e kemi nisur me postë, me zarf dhe data e nisjes është 16.04.2021.

Z. I. Rusmali: Në proces shqyrtimi ka qenë prezent ose i përfaqësuar personi?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk ka qenë.

Z. I. Rusmali: Dhe nuk dihet pse nuk ka qenë!

Z. I. Rusmali: Është njoftuar të paktën për këtë proces?

Z. Y. Merkaj: Po, është njoftuar!

Z. E. Lako: Me datë 16 është nisur me postë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

Z. Y. Merkaj: Po dhe ka mbërritur në Bashkinë e Librazhdit.

Z. E. Lako: Atëherë, pas verifikimeve që bëri komisioni, lidhur me datën e dorëzimit të vendimit pranë Bashkisë Librazhd, ankuesi nuk ka respektuar afatin ligjor për ankimin që përcakton neni 124 i Kodit Zgjedhor, sepse vendimi është marrë në 14.04.2021 dhe ankuesi e ka paraqitur ankimin tej afatit ligjor, pra më 22.04.2021. Pas verifikimit të dërgimit të postës rezulton se në datë 16.04.2021 është marrë në dorëzim. Ky ankim është bërë jashtë afatit dhe për këtë arsye Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi të mos e kalojë këtë ankim për shqyrtim.

Vendimi nr.28

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

22.04.2021
Ora 18:10

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.19, subjekti
ankues Partia Aleanca Demokracia e Re"**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. L. Braho: Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr.19. Subjekti zgjedhor Aleanca Demokracia e Re, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Kërkesën Ankimore nr.19. Kërkesë ankimore që bëhet ndaj vendimit nr.2, të datës 21.04.2021 të KZQZ-së nr.33 Qarku Tiranë. Në objekt kërkohet "Ndryshimi i vendimit të kësaj KZAZ-je dhe pranimi i listës së vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re". Seanca e sotme është seancë e kritereve formale të ankimit. Nga administrata në lidhje me këto kritere?

Z. Y. Merkaj: Kërkesa Ankimore nr.19, është ankimuar vendimin e KZAZ-së nr.33, të datës 21.04.2021. Kërkesa është dorëzuar në datën 22.04.2021, brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin e ankimit. Ankimohet nga subjekti Partia Aleanca Demokracia e Re, e cila është subjekt që janë cënuar interesat e ligjshme pasi është refuzuar lista e vëzhguesve. Kompetenca e Komisionit të KAS-it është pasi ankimoi dhe vendimin e KZAZ-së. Nga ana formale kërkesa nuk plotëson

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

kriteret pasi nuk është sipas formatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Për sa i përket formatit në lidhje me elementet, a janë të gjitha elementet sipas formatit të KQZ-së?

Z. Y. Merkaç: Po të gjitha elementet janë sipas formatit.

Z. L. Braho: Faleminderit, përfaqësuesi i Aleancës Demokratia e Re, në qoftë se ka ndonjë gjë në lidhje me këto çështje?

Z. E. Stojku, përfaqësues i ADR-së: Më tepër për procedurë, në rastin që i kam ankimuar janë me shkrim aty. Në rastin e Kavajës e cila nuk pranoi të kthejë përgjigje doja ta bëjë me dije që KZAZ-ja e Kavajës nuk mori as në konsideratë protokollimin e shkresës sonë domethënë ishte Kavaja. Nuk është në këtë listë sepse ata nuk na e pranuan fare që të plotësonim formatin e ankimit se duhet të kemi të gjitha të dhënat shkresore të formatit të mospranimit të vëzhguesve që ne të bëjmë pastaj kërkesën për ankimim. Doja thjesht ta bëj me dije pastaj, nesër një ankimim tjetër, 12 KZAZ i kanë pranuar vëzhguesit tanë.

Z. L. Braho: Së fundi lexoj vendim të Kolegjit Zgjedhor dhe thoshte: Drejtësia në çështjet zgjedhore nuk vepron me analogji po në bazë të ligjit kështu që gjithsesi argumentin ruaje për themelin po për sot nuk është e nevojshme.

Z. I. Rusmali: Një pyetje pse nuk keni zbatuar formatin e KQZ-së po keni zgjedhur një format tjetër për ankesë?

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

Z. E. Stojku, përfaqësues i ADR-së: Atëherë nuk kemi zgjedhur format tjetër në fakt, e kemi bërë me juristin e partisë, nuk e gjetëm në faqen e KQZ-së. Faji është i joni po e mbajmë si faj sepse vajzat poshtë më sqaruan që e ke patjetër në linkun e KQZ-së në website-in, herë tjetër të jesh i sigurtë që do ta zbatojmë.

Z. L. Braho: Atëherë Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve vendos ta kalojë çështjen për shqyrtim administrativ, por duke qenë se Kërkesa Ankimore nr.19 dhe Partisë Aleanca Demokracia e Re është ndaj një vendimmarrje të KZAZ-së nr.33.

Vendimi nr. 29

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**22.04.2021
Ora 18:16**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.20, subjekti
ankues Partia Aleanca Demokracia e Re".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. I. Rusmali: Nga i njëjti subjekt është paraqitur me të njëjtin objekt një tjetër kërkesë ankimore ndaj KZAZ-së nr.41. Sekretari i Përgjithshëm çfarë na shpjegon për pjesën formale?

Z. Y. Merkaj: Kërkesa Ankimore është depozituar në datën 22.04.2021 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili ankimon vendimin e KZAZ-së nr.41 për refuzimin e listave të vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re. Në lidhje me informal të kërkesës ankuesi Partia Aleanca Demoracia e Re legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë pasi janë cënuar interesat e ligjshme për caktimin e vëzhguesve. I është drejtuar KAS-it si organit kompetent për shqyrtimin e ankimeve të KZAZ-ve. Është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në ligj brenda afatit 3 ditor. Plotëson element formal të kërkesës vetëm nga ana formale, kërkesa nuk është bërë sipas formatit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

Z. I. Rusmali: Për këtë marrëm një vendim në kërkesën e mëparshme në lidhje me formatin. Ndonjë gjë për të shtuar nga subjekti? Nuk ka, kalon për shqyrtim nesër në orën 11:30. E mbylлим këtu këtë çështje.

Vendimi nr.30

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**22.04.2021
Ora 18:17**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.21, subjekti
ankues Partia Aleanca Demokracia e Re".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. E. Lako: Kërkesa Ankimore nr.21, kërkues Partia Aleanca Demokracia e Re, ankohet kundër vendimit nr. 226, datë 22.04.2021, të KZAZ-së nr.30, Qarku Tiranë. Kërkohet ndryshimi i vendimit dhe pranimi i listës së vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re.

Z. Y. Merkaj: Kërkesa ankimore është dorëzuar në datën 22.04.2021, ankimohet vendim i KZAZ-së nr.30 datë 21.04.2021. Është brenda afatit të përcaktuar në ligj. Legjitimohet në mbledhje të kësaj kërkesë pasi janë cënuar të drejtat për të caktuar vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Prandaj i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve si organ kompetent që shqyrton ankimet e KZAZ-ve. I plotëson të tre elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor.

Z.E.Lako: Atëherë dhe kjo pranohet dhe kalon për shqyrtim. **Vendim nr.31**

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**22.04.2021
Ora 18:19**

RENDI I DITËS

**Projekvendimi " Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.22, subjekti
ankues Partia Aleanca Demokracia e Re"**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. K. Bele: Kërkesa Ankimore 22, datë 22.04.2021, ankues kërkues Partia Aleanca Demokracia e Re, kundër vendimit të KZAZ-së nr.27, Qarku Tiranë me të njëjtën objekt për refuzimin e akreditimit të vëzhguesve.

Z.Y.Merkaj: Edhe kjo kërkesë plotëson kriteret e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, si afatin legjitimimin dhe kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e çështjes, faleminderit.

Z. K. Bele: Faleminderit, atëherë KAS-i i konsultuar vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë në ditën e nesërme në orën 11:45.

Vendim nr.32

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**22.04.2021
Ora 18:20**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.18, subjekti
ankues Partia Lëvizja për Ndryshim".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. E. Çefa: Vazhdojmë seancën paraprake për Kërkesën Ankimore nr.18, datë 22.04.2021. Në cilësinë e relatorit të caktuar nga KAS me shortin e datës të sotme, parashtroj përpara jush se kjo ankesë është hartuar nga Partia Lëvizja për Ndryshim dhe ka për objekt "Shfuqëzimin e vendimit nr.11, datë 20.04.2021, të KZAZ-së nr.52, Qarku Elbasan" I është refuzuar gjithashtu dhe kësaj partie akreditimi i listës së vëzhguesve. Nga një vlerësim paraprak i elementeve procedural formal rezulton se ankesa është bërë brenda afatit. Subjekti ka legjitimitet për t'u drejtuar KAS-it, KAS-i gjithashtu ka kompetencë për të shqyrtuar këtë kërkesë dhe në këtë këndvështrim propozoj që ta kalojmë për shqyrtim, nesër në datën 23 Prill ora 12:00, faleminderit. Seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendim nr.33

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



**22.04.2021
Ora 18:18**

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.15 me Kërkesën Ankimore nr.21".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z.E.Lako: Komisioni i Ankimimeve vendos që t'i bashkojë dy kërkesat ankimore atw me nr.15 me Kërkesën Ankimore nr.21 dhe relator të jetë zoti Ilir Rusmali. Seanca zhvillohet nesër në orën 11:00.

Vendimi nr.34



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.04.2021*

22.04.2021
Ora 18:14

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.16 me Kërkesën Ankimore
nr.19"**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** ADR

Z. L. Braho: Komisioni i Ankimimeve vendos që në zbatim të nenit 65, shkronja "ç", t'i bashkojë këto dy çështje për t'i gjykuar së bashku dhe duke qenë se relator te të dy çështjet jam unë anëtari Ledio Braho, unë do të jem relator dhe për çështje e re që është bashkimi i këtyre dy çështjeve.

Seanca do të zhvillohet nesër në orën 11:15, data 23 Prill 2021.

Vendimi nr. 35

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

**23.04.2021
Ora 12:43**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.23 me subjekt
ankues Partia Aleanca Demokracia e Re”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. K. Bele: Fillojmë shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 23, me subjekt Partinë Aleanca Demokracia e Re, kundër vendimit nr.15, të KZAZ-së nr.38, Qarku Tiranë për ndryshimin e vendimit të KZAZ- së nr.38 dhe pranimin e listës së vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re. Sekretari Përgjithshëm shkurtimisht ju lutem!

Z. Y. Merkaj: Ankimohet Vendimi nr.15, datë 22.04.2021, i KZAZ-së nr.38 për refuzimin e listave të vëzhguesve të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re. Është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në ligj. I drejtohet KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë, që shqyrton kërkesat kundër vendimeve të KZAZ-ve. Legjitimohet subjekti i kërkesës, pasi çënohen interesat e ligjshme të subjektit zgjedhor.

Z. K. Bele: Ju faleminderit, kërkesa s’kemi. KAS-i vendosi shqyrtimin në një seancë sa më të afërt në konsultim me subjektin zgjedhor për efekt të kohës. Ju lutem të komunikohet me subjektin ankues të Kërkesës Ankimore nr.23, Partia Aleanca Demokracia e Re.

Vendimi nr.36

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

**23.04.2021
Ora 11:15**

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.15 dhe nr.21 të subjektit ankues BD dhe ADR".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto.
- **Parti Politike:** BD, ADR

Z. I. Rusmali: Fillojmë mbledhjen. Në këtë seancë do të shqyrtojmë kërkesën ankimore të subjektit Partia Bindja Demokratike kundër vendimit të KZAZ-së nr.30 për mosakreditimin e vëzhguesve të këtij subjekti si dhe në përputhje në vendimin e marrë dje nga KAS-i, kërkesën tjetër ankimore të subjektit Partia Aleanca Demokracia e Re, me të njëjtën lëndë dhe kundër vendimit respektiv të të njëjtit komision zgjedhor. Janë prezent përfaqësuesit e palëve, të cilët mund të prezantohen përpara komisionit.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Fabjan Topollari, përfaqësues i Bindjes Demokratike, person i akredituar pranë KQZ-së.

Z. E. Stojku, përfaqësues i ADR-së: Atëherë Edmond Stojku, Kryetar i Partisë Aleanca Demokracia e Re.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. I. Rusmali: Gjithashtu prezent janë përfaqësuesit e administratës, Sekretari i Përgjithshëm dhe bashkëpuntorët e tij si zakonisht në mbledhjet e këtij komisioni. Sekretar i përgjithshëm një prezantim të shkurtër të çështjes.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur Kërkesa Ankimore nr.15, datë 21.04.2021 dhe Kërkesa Ankimore nr.21 datë 22.04.2021. Objekti i Kërkesës Ankimore nr.15 është kundërshtim i vendimit të KZAZ-së nr.30 për refuzimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Ankimuesi është Bindja Demokratike, nga një vështrim i shkurtër i ankimit ata pretendojnë se janë brenda afatit ose janë shkelur të drejtat e tyre për të caktuar vëzhgues pavarësisht se kërkesën e ka paraqitur jashtë afatit 15 ditor siç përcaktohet në nenin 6 të Kodit Zgjedhor. Çështja ka ardhur për shqyrtim në Komision Ankimeve dhe Sanksioneve, pas caktim të relatorit është zhvilluar seanca paraprake dhe sot jemi në zhvillimin e shqyrtimit.

Z. I. Rusmali: Faleminderit, kërkesa për të marrë pjesë si palë të interesuara nuk ka?


Z. Y. Merkaj: Jo nuk ka!

Z. I. Rusmali: Përpara se të kaloj fjalën përfaqësuesve të subjekteve, ka ndonjë kërkesë specifike në raport me KAS-in, për përjashtim të anëtarëve ose ndonjë gjë të tillë të kësaj natyre nga ana juaj? Jo nuk kanë, vetë anëtarët nuk kanë, e mbyllim dhe këtë pjesë të formës. Përfaqësuesi i Bindjes Demokratike, ju lutem çfarë i kërkon KAS-it?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Partia Bindja Demokratike ka dërguar në KZAZ-në nr.30, kërkesën e saj për akreditimin e vëzhguesve dhe një ditë më pas kjo KZAZ ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin që Partia Bindja Demokratike nuk plotëson kriteret e nenit 6, të Kodit Zgjedhor, praktikisht të parashikuar nga pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor. Nëse do të lexojmë ligjin “Kodi Zgjedhor në pikën 1 dhe 4 të tij, tregon subjektet që kanë të drejtë të kenë vëzhgues pranë vend numërimeve dhe vend votimeve”. Kërkesa jonë ka qenë vetëm për vëzhgues pranë KZAZ-së dhe pranë vend votimeve. Kërkesa që kemi në shqyrtim është refuzuar pavarësisht se Partia Bindja Demokratike përmbush kriteret e parashikuara nga pika 1 dhe 4 i nenit 6 për shkak se neni 6 në pikën 1 dhe 4 të tij parashikon të drejtën e pasjes së vëzhguesve ka çdo subjekt zgjedhor që ka regjistruar një listë shumemërore në zgjedhjet e përgjithshme. Partia Bindja Demokratike është një subjekt zgjedhor në bazë të vendimit të Komisionerit është regjistruar si subjekt zgjedhor. Ka regjistruar edhe listën e saj shumemërore dhe për këtë arsye ajo ka të drejtë të ketë vëzhgues në çdo vend numërim. Sa i përket aspektit të afatit është e vërtetë që në udhëzuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve drejtuar KZAZ-ve ka një afat. Ky është udhëzuesi kryesor mbi bazën e së cilës duhet të organizojë punën e saj çdo KZAZ po aq e vërtetë është që ky udhëzues kërkon që në raste të ngjashme partive politike dhe subjekteve zgjedhore t’i lihet mundësia e plotësimit të dokumentacionit. Pra refuzimin e akreditimit të vëzhguesve e lidh vetëm me mosplotësimin e dokumentacionit dhe dokumentacioni ka 3 kushte: Të jetë parti subjekt zgjedhor i regjistruar si i tillë. Të ketë një kërkesë nga ana e subjektit zgjedhor dhe një vetdeklarim për gjendjen gjyqësore të vëzhguesve. Në rast se nuk plotësohet një nga kriteret, KZAZ-ja ka detyrimin që ta rikthej për plotësim aktin pra kërkesën e subjektit zgjedhor për vëzhguesit dhe vetëm nëse nuk plotësohet një



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

nga këto 3 kritere ka të drejtë që t'i refuzojë vëzhguesit. Ne nuk jemi në këto kushte, sepse subjekti zgjedhor Bindja Demokratike i ka plotësuar të tre kriteret edhe ka paraqitur një kërkesë edhe është një subjekt zgjedhor i regjistruar me listën e saj shumemërore. Ju vë në vëmendje që vëzhguesit për partitë e tjera përjashtojnë 4 partitë kryesore të opozitës dhe të mazhorancës që kanë numëruar në grupet e numërimit është e vetmja e drejtë që partitë e tjera kanë në këtë proces. Mohimi i kësaj të drejte është me dëm të jashtëzakonshëm për subjektet e tjera zgjedhore. Ne kemi një Kod Zgjedhor të ndërtuar në administrimin e numërimit të votës dhe të administrimit të gjithë procesit zgjedhor ditën e votimit dhe në numërimin e saj me komisionerë të partive politike dhe vetëm të 4 të tillave, të gjithë të tjerët kanë vetëm të drejtën e vëzhguesve. Kështu që kjo është një e drejtë e epërme që nuk mund të mohohet në asnjë rast aq më tepër që kjo kërkesë është bërë shumë ditë përpara se të fillojë ky proces, procesi i numërimit të votave që do të vëzhgohet nga vëzhguesit tanë. Për këtë arsye kërkoj që të pranohet kërkesa jonë ankimore sipas objektit të saj.

Z. I. Rusmali: Faleminderit, pyetje nga kolegët?

Z. K. Bele: Kisha një pyetje për sekretarin e përgjithshëm, doja të di në dijeninë tuaj, është përfunduar ky proces në të gjitha KZAZ-të e tjera për partitë kryesore përveç këtyre çështjeve të ankimuara, nëse keni dijeni.

Z. Y. Merkaç: Po është përfunduar dhe vetëm 3 parti për subjekte zgjedhore kanë paraqitur kërkesë në KQZ, subjektet e tjera kanë regjistruar vëzhguesit, brenda afatit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. K. Bele: Meqënëse jemi këtu sipas nenit 36, thjesht për të kuptuar më shumë. Propozime për anëtarë të KQV-ve bëhen jo më vonë se 30 ditë para zgjedhjeve, emërimi i tyre jo më vonë se në çdo rast thotë ligji se 20 ditë para zgjedhjeve. Në dijeninë tuaj ka përfunduar dhe ky proces i komisionerëve në shkallë vendi?

Z. Y. Merkaj: Po ka përfunduar, sepse të drejtën për zëvendësimin e anëtarëve e ka partia subjekti që propozon kështu që ka dhe zëvendësime. Procesi ka përfunduar.

Z. K. Bele: Por janë emëruar.

Z. Y. Merkaj: Po janë emëruar.

Z. K. Bele: Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër?

Z. E. Çefa: Kam unë një pyetje për ankuesin. Ky fenomeni i refuzimit të akreditimit, është vetëm për këtë kërkesën që keni paraqitur ankim ose e thënë ndryshe në KZAZ-të të tjera i keni regjistruar brenda afateve vëzhguesit?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Ne vëzhguesit i kemi dërguar pak a shumë në të gjithë KZAZ-të e Shqipërisë në këto data 18,19, 20. Për hir të së vërtetës, sepse i kemi dërguar njëkohësisht se menduam që t'i bënim të gjithë bllok dhe pastaj t'i dërgonim. Të vetmet që kanë refuzuar janë rasti i kërkesës ankimore tuajën. Një rast tjetër që ne e kemi ankimuar dhe një rast që na ka ardhur dje në

5

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

darkë që në varësi të vendimit tuaj sot do të bëjmë ankimin tjetër. Të gjithë të tjerët i kanë pranuar në dijeninë tonë kërkesën tonë për akreditimin e vëzhguesve. Tani unë kam vetëm një plotësim të vogël dhe ju kërkoj ndjesë, është e vërtetë që neni 6 i Kodit Zgjedhor në pikën 5 të tij thotë që “Kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim paraqiten në KQZ jo më vonë se 15 ditë përpara datës së zgjedhjeve. KQZ-ja miraton kërkesat jo më vonë se 5 ditë”. Fakti që neni 5 tregon që ky afat depozitohet pranë KQZ-së dhe jo pranë KZAZ-ve do të thotë që e ka fjalën për vëzhguesit e tjerë jo për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore se vëzhguesit e subjekteve zgjedhore paraqiten pranë KZAZ-ve nuk paraqiten pranë KQZ-së. Udhëzuesi nuk ka asnjë afat për subjektet zgjedhore se kur duhet të paraqesin vëzhguesit e tyre. Edhe një gjë tjetër, udhëzuesi është sipas jurisprudencës dhe doktrinës, është një akt normativ që nocionet qendrore ua japin nëpunësve të tyre për zbatim. Nuk është një akt që krijon detyrime udhëzuesi për subjektet e tjera, vetëm për nëpunësit e KQZ-së, në këtë rast në KZAZ. Pavarësisht kësaj, udhëzuesi nuk thotë në asnjë pjesë të tij që kërkesa e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve mund të refuzohet për shkak të ndonjë afati, në asnjë pikë të sajën. Ndërsa ajo që përmendi sekretari i përgjithshëm neni 5, nuk e ka fare fjalën për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore e ka fjalën për vëzhguesit e tjerë.

Z. I. Rusmali: T’iu pyes këtë kërkesë në KZAZ nr.30, në cilën datë e keni depozituar?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve tanë është depozituar në datë 20 dhe në datë 21 ne kemi marrë përgjigjen që e kemi ankimuar.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. I. Rusmali: Po, pyetje tjetër?

Z. L. Braho: Kam një pyetje për administratën, përveç udhëzuesit që citon: Pala ankimuese ka dhe një udhëzim nr.2 të datës 02 Shkurt 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me vëzhguesit, që përcakton dhe afatet e parashikuara, afatin 15 ditor. Në qëndrimin e administratës së KQZ-së duke ju referuar dhe të kaluarës, ka pasur raste të ngjashme? Afati mesa pashë unë ishte afat në Kod Zgjedhor i parashikuar që në kodin origjinal pa ndryshime. Nuk është një afat i ri që është parashikuar me ndryshimet e fundit, në historikun e vendimmarrjeve të KQZ-së ka pasur raste të ngjashme?

Z. Y. Merkaj: Ka pasur raste të ngjashme.

Z. L. Braho: Çfarë qëndrimi është mbajtur?

Z. Y. Merkaj: Janë pranuar vëzhguesit.

Z. L. Braho: Nga KZAZ-të apo nga KQZ-ja?

Z. Y. Merkaj: KQZ-ja ka detyruar KZAZ-në të akreditojë vëzhguesit e subjekteve.

Z. I. Rusmali: Faleminderit pyetje tjetër? Lidhur me kërkesat tona për informacion ka pasur ndonjë informacion nga KZAZ-ja?

Z. I. Rusmali: Mund të na i thuash shkurtimisht shpejt?

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. Y. Merkaj: Komunikuam me KZAZ-në nr.30 dhe kërkesën e parë sa subjekte zgjedhore janë regjistruar kanë miratuar vëzhguesit pothuajse të gjitha subjektet zgjedhore me përjashtim të Partisë Bindja Demokratike dhe Aleanca Demokracia e Re nuk janë refuzuar. Janë te këto të dyja që është rrëzuar kërkesa. A është komunikuar me KZAZ-të për subjektet thotë për datën 10 prill që është 15 ditë para datës së zgjedhjeve nuk është komunikuar dhe pasi është e përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe udhëzimin nr.2 dhe duhet ta dini presupozohet të jetë subjekte zgjedhore duhet ta dinë afatin e dorëzimit të listave të vëzhguesve. Në lidhje me pyetjen 4 midis rrëzimit të kërkesës dhe miratimit ku është ngarkesa ose diferenca nuk ka asnjë ngarkesë as diferencë, por thjesht u vendos me shumicë votash që të mos pranohet pasi është jashtë afatit ligjor, këto ishin përgjigjet.

Z. I. Rusmali: Faleminderit mund të kalojmë te subjekti tjetër?

Z. L. Braho: Kisha një pyetje tjetër informacioni që mund të na japë KQZ-ja, KZAZ-të kur kanë filluar punën full time që janë gjatë gjithë kohës në qendrat e tyre ku kanë selitë KZAZ-të përkatëse? Sa kohë ka?

Z. Y. Merkaj: 90 ditë para ditës së zgjedhjeve konsultohen.

Z. L. Braho: Të gjithë ata që janë anëtarë KZAZ-je supozohet që 90 ditë para ditës së zgjedhjeve punojnë?

Z. Y. Merkaj: Po janë të emëruar, mbledhen dhe ushtrojnë detyrën.

Z. L. Braho: Pra, janë gjatë gjithë kohës në seli?

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. Y. Merkaçaj: Gjatë gjithë kohës, ndoshta 8 orë jo por që me afate intervale ose afate të reduktuara mblidhen.

Z. L. Braho: Një pyetje për ankimuesin, po situata e pandemisë ka qenë problem në lidhje me këtë aspektin e gjetjes së njerëzve e nënshkrimit dhe plotësimt të dokumentacionit?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Po sigurisht dhe kjo ka pasur ndikimin e saj dhe fakti që ne i kemi çuar njëkohësisht të gjithë kemi pritur që t'i plotësojmë të gjitha të plota në të gjithë Shqipërinë dhe pastaj i kemi çuar njëkohësisht sepse e kemi bërë plotësimin e dokumentacionit për saktësi absolute dhe pranë zyrave tona qendrore edhe kjo ka qenë një arsye.

Z. I. Rusmali: Faleminderit, mund të kalojmë besoj te subjekti tjetër. Ju lutem prezantohuni!

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Jam Endrit Osmani të nderuar, për Partinë Aleanca Demokracia e Re, përfaqësues i akredituar pranë KQZ-së. Edhe ne si kolegu parafolës pak a shumë ndajmë të njëjtin shkak ankimi ku kemi paraqitur pranë jush kërkesën për ndryshimin e vendimit të KZAZ-ve fillimisht KZAZ-në 33 nëse nuk gabohem, e cila në paraqitjen e listës sonë të vëzhguesve nuk e ka pranuar si kërkesë. Pak a shumë në rrethanat që kemi prapësuar në ankimin tonë, citojmë në mënyrë thelbësore që nuk besojmë se është në të drejtat e KZAZ-së, të kufizojë një të drejtë të një subjekti politik siç e parashikon Kodi Zgjedhor në nenin 6, fillimisht për akreditimin e vëzhguesve pranë qendrave të numërimit dhe KZAZ-ve. Në asnjë moment nuk është parashikuar që ky afat e shuan të drejtën e

9

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

një subjekti politik në rrethanat ku ne sot shoqëria jonë operon dhe vetë ligjvënësi me ndryshimet që bëri në Kodin Zgjedhor në vitin e shkuar nuk mund ta kishte parasysh që veprimtaria sociale e gjithë shqiptarëve do të kryhej në kufizime të mëdha po themi. Ne si forcë politike e kemi pasur tepër të vështirë të organizojmë numrin e nevojshëm për anëtarët tanë si vëzhgues pranë qendrave e pranë KZAZ-ve. Prandaj kjo ka ndikuar dhe me një afat në një zgjatje në vonesë të paraqitjes së listave. Kjo për shkak se grumbullimet në zbatim të ligjit janë në numër të ulët njëerëzish, nuk mund të grumbullonim një numër maksimal siç e kërkonte çdo KZAZ nëpër republikë. Në rastin tonë, ky rast si në një objekt ankimi janë raste përjashtimore duke qenë se në shumicën e KZAZ-ve ku ne kemi paraqitur listat janë pranuar pa vërejtje edhe kryesisht kemi pasur bashkëpunim me anëtarët e çdo KZAZ-je. Rrethanat janë shumë të ngjashme dhe në subjektin tjetër. Prandaj ne i ndajmë këto shqetësime, por nuk do të thotë se vonesat janë të arsyeshme për rrethanat ku jemi. Ky kufizim na përjashton ne në çdo moment të vetmin mjet që kemi për të qenë aktor aktiv në procesin e numërimit të votave duke qenë se si parti nuk kemi përfaqësi në tavolinën e numërimit. Prandaj do të kërkonim ndryshimin e vendimit të KZAZ-së edhe pranimin e listës së vëzhguesve tanë dhe akreditimin e tyre pranë KZAZ-së përkatëse.

Z. I. Rusmali: Ju në cilën datë e keni paraqitur kërkesën?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Për KZAZ-në në fjalë bëhet fjalë për në datën 20 Prill dhe në 21 Prill kemi marrë vendimin për refuzim.

Z. I. Rusmali: Pyetje?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. E. Çefa: Kam të njëjtën pyetje që i bëra dhe përfaqësuesit të Partisë Bindja Demokratike. Ky është fenomen masiv apo është i kufizuar vetëm në këto KZAZ për të cilat keni bërë ankim?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Fenomeni është tejësisht i veçuar, në total forca jonë politike ka vetëm 4 KZAZ ku kemi hasur vështirësi në akreditimin e vëzhguesve për të cilin kemi paraqitur ankimin përkatës.

Z. E. Çefa: Në KZAZ-të e tjera ku ju është pranuar akreditimi i vëzhguesve në këto data është paraqitur kërkesa apo më herët?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Në këto interval datash nga data 19 deri në datën 22.

Z. E. Çefa: Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër?

Z. L. Braho: Kam një pyetje për Administratën e KQZ-së, ka ndonjë detyrim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i trajnojë vëzhguesit e subjektit zgjedhor?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. L. Braho: Nuk është se duhet kohë për t'i trajnuar. Edhe një pyetje për të dyja subjektet, mesa kam kuptuar unë bëhet fjalë vetëm për vëzhgues në vendet e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

numërimit të votave, nuk bëhet fjalë për vëzhgues në çdo qendër. Për sa vëzhgues bëhet fjalë përsëmbull në KZAZ-në nr.30 që është objekt?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Një numër mesatar 6 persona të cilët alternohen gjatë gjithë veprimtarisë së numërimit.

Z. L. Braho: Edhe për Bindjen Demokratike aq bëhet fjalë?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Po sepse sipas udhëzuesit dhe ligjit ne kemi të drejtë nga një përfaqësues në secilën KZAZ dhe pastaj nga një vëzhgues përballë secilës tavolinë numërimi.

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër nuk ka. Ndonjë kërkesë specifike? Nuk ka. Ndonjë gjë për të thënë në përfundim përveç atyre që kemi thënë deri tani? Nuk besoj se ka! Besoj se mund të mblidhemi për të marrë vendim.

Z. L. Braho: Unë kisha një propozim meqenëse palët janë dhe tek çështja tjetër që jam unë relator ku janë bashkuar dy ankimet po ashtu dhe janë të njëjtat palë. Mbase do të ishte mirë ta shqyrtonim dhe atë seancë dhe të dalim në vendime për të dyja. Vendimet janë veçmas shpallen veçmas po pasi t'i dëgjojmë dhe në lidhje me këtë çështje. Meqenëse është i njëjti arsyesim besoj..

Z. I. Rusmali: Dakord. Atëherë tërhiqemi për vendim.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Rifillon Mbledhja

Ora 12:24

Z. I. Rusmali: Mirë, atëherë riçelim seancën për shpalljen e vendimit për Kërkesën Ankimore nr.15 dhe nr.21, të subjekteve zgjedhore Bindja Demokratike dhe Aleanca Demokracia e Re. KAS-i pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe administroi provat vendosi:

1. Pranimin e kërkesave ankimore të subjekteve zgjedhore Partia Bindja Demokratike dhe Partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 30 që të akreditojë vëzhguesit e subjekteve ankuese, sipas kërkesave të depozituar prej tyre në KZAZ.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare.
4. Mund të bëhet ankim kundër tij në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve.

Vendimi nr.37

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

**23.04.2021
Ora 11:37**

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.16 dhe nr.19 të subjektit ankues BD dhe ADR".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto.
- **Parti Politike:** BD, ADR

Z. L. Braho: Atëherë sot në datë 23 prill, të vitit 2021 pas seancës së djeshme ku u shqyrtua në lidhje me Kërkesat Ankimore nr.16 dhe nr. 19. Kërkesa Ankimore nr.16 e Partisë Bindja Demokratike dhe Kërkesa Ankimore nr.19 e Partisë ADR, u vendos për të dyja kërkesat që të kaloheshin për shqyrtim administrativ ditën e sotme. Po ashtu u vendos edhe bashkimi i këtyre çështjeve në bazë të nenit 65 shkronja "ç", të Kodit Procedurës Administrative meqënëse bëhet fjalë për të njëjta fakte dhe për vendimmarrje të të njëjtës KZAZ që është KZAZ-ja nr.33. Këto çështje do të shqyrtohen bashkarisht sot, relator jam unë anëtari Ledio Braho, i caktuar me short për të dyja çështjet. Keni ndonjë kërkesë paraprake në lidhje me ndonjë anëtar nga anëtarët e KASI-it? Nuk ka. Vazhdojmë shqyrtimin nga KZAZ-ja është i njëjti relativ jemi në të njëjtat kushte.

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. Y. Merkaç: Po të njëjta kushte jemi, arsyeja që i kanë refuzuar listat e vëzhguesve është tejkalimi i afatit 15 ditor që përcakton neni 6 i Kodit Zgjedhor dhe neni 9 i udhëzimit nr.2 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Shkurtimisht nga të dyja palët megjithëse bëhet fjalë për të njëjta argumente si në çështje të mëparshme. Shkurtimisht argumentet në lidhje me ankimet tuaja, në qoftë se ka ndonjë gjë specifike.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Vetëm një gjë kam, në fakt arsyetimet e dy KZAZ-ve të ndryshme janë krejt të ndryshme dhe baza ligjore që ato kanë përdorur. Ajo që shqyrtuam para me relator zotin Rusmali, arsyetimi ka qenë që ne nuk përmbushnim kriteret e pikës 1 dhe 4, të nenit 6 pra ne nuk ishim subjekte zgjedhore që kishim regjistruar lista shumemërore. Kërkesa Ankimore nr.16 e jona ka pasur për objekt të mosakreditimit të vëzhguesve çështjen e afatit. Këtu unë dua të them vetëm dy fjalë shtesë së është pak a shumë e njëjta gjë e thashë dhe pak më përpara. Është e vërtetë që në pikën 5 të nenit 6, ka një afat për kërkesa vëzhguesish shqiptar për akreditimin paraqitjen e KQZ-së jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve. Por kjo nuk është për subjektet zgjedhore, sepse subjektet zgjedhore dhe e drejta e tyre për të pasur vëzhgues parashikohet nga pika 1 e nenit 6, ku thotë “çdo subjekt zgjedhor”. Ndërsa pika 2 kur flet për organizatat jo qeveritare shqiptare janë të tjerë vëzhgues nuk është fjala për subjektet zgjedhore. Pika 5 ku thotë që vëzhguesit shqiptarë për akreditimin i paraqiten KQZ-së jo më vonë se 15 ditë, e ka fjalën pikërisht për organizatat joqeveritare shqiptare, sepse në të njëjtën pikë te pika 5 pastaj vazhdon dhe vë afate dhe për shoqatat e huaja për këto vëzhguesit e huaj që kanë një tjetër afat dhe nuk është për subjektet zgjedhore, e para sepse nuk shprehet për subjektet zgjedhore pika 5, e nenit 6. E dyta sepse

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

subjektet zgjedhore i paraqesin kërkesat për vëzhgues pranë KZAZ-ve dhe jo pranë KQZ-së. Kështu që është një interpretim krejtësisht i gabuar nëse në themi se ka një afat për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore. Për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk ka asnjë afat dhe ai që unë shpreha pak më parë në udhëzim nuk është i detyrueshëm për subjektet zgjedhore. Udhëzimi është i detyrueshëm për organizimin e punës së Administratës së KQZ-së. Përpos që dhe udhëzimi nuk thotë as një penalitet për mosrespektimin e atij afati që vihet, faleminderit.

Z. L. Braho: Një pyetje Fabian, në këto KZAZ ku iu është refuzuar e drejta për të caktuar vëzhgues. Për subjektin tuaj zgjedhor, ka ndonjë mundësi tjetër për ta vëzhguar procesin e numërimit administrimit dhe KZAZ-ja?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD-së: Unë e thashë dhe në parashtrimin e çështjes së parë. E vetmja mundësi që ne të jemi pjesë e këtij procesi është pikërisht nëpërmjet këtyre vëzhguesve, kështu që në këtë rast ne na mohohet fare mundësia për të qenë pjesë e procesit qoftë e dhe vetëm në vëzhgim, sepse ligji e parashikon që të drejtën e organizimit të këtij procesi pra në formë aktive janë vetëm 4 partitë kryesore dy të maxhorancës, dy të opozitës.

Z. L. Braho: Faleminderit pyetje nga anëtarët? Nuk ka. Vazhdojmë me ankimuesin tjetër Partinë ADR në qoftë se ka ndonjë gjë më specifike.

Z. E. Osmani, përfaqësues i ADR-së: Në përmbajtje i referohemi të gjitha shkaqeve duke qenë se dhe shkak i KZAZ-së ka qenë afati thelbësor.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. L. Braho: Faleminderit atëherë KAS do të tërhiqet për vendim për të dyja çështjet.

Rifillon Mbledhja

Ora 12:25

Z. L. Braho: Atëherë riçelet seanca dhe për shqyrtimin e Kërkesave Ankimore nr.16 dhe nr.19, të depozituara përkatësisht nga subjektet zgjedhore Partia Bindja Demokratike dhe partia Aleanca Demokracia e Re. KAS pasi u tërhoq për vendim, mbështetur në shkronjën “c”, pikës 1 të nenit 30, të vendimit të Komisionit Rregullator, vendos:

1. Pranimin e kërkesës së subjekteve zgjedhore Partia Bindja Demokratike dhe Partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 33 të akreditojë vëzhguesit e subjekteve ankuese, sipas kërkesave të depozituar prej tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr.38

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



RENDI I DITËS

**Projektvendim "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.20, të subjektit ankues
ADR".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto.
- **Parti Politike:** BD, ADR

Z. I. Rusmali: Kërkesa Ankimore nr. 20 ka për subjekt Partinë Aleanca Demokracia e Re që është e përfaqësuar në këtë seancë dhe drejtohet kundër vendimit të KZAZ-së nr.41, për mospranim, për refuzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga udhëzuesi i miratuar nga Komisioni Rregullator. Nëse ka ndonjë gjë specifike që doni të trajtoni?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Jo nuk kemi, pasi është i njëjti shkak.

Z. I. Rusmali: Është e njëjta çështje. Të njëjtat diskutime, sigursht vlen për t'u theksuar vetëm fakti që KZAZ-ja nuk ka prezantuar një vendim sipas formatit. Por, ka prezantuar një shënim në procesverbalin e mbledhjeve, që nuk ndryshon ndonjë gjë në përmbajtje vetëm se forma është e ndryshme. Gjë tjetër nuk ka specifike për

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

të trajtuar. Nuk është se keni ndonjë gjë më shumë për të shtuar? Në fakt procesverbali tregon që këta kanë marrë vendim. Por, vendimi sipas formatit që kanë ata nuk është plotësuar. Sipas formatit i është dhënë subjektit fotokopja e procesverbalit gjë që për shqyrtimin tonë..

Z. Y. Merhaj: Kemi komunikuar me KZAZ-në 41. Ata kanë vendosur dhe kanë pasqyruar tek libri i protokollit, por për shkak të ngarkesës thanë nuk e kemi bërë por po e bëjmë gati edhe nga ana formale.

Z. I. Rusmali: Ne nuk na pengon shqyrtimin e çështjes dhe trajtimin e kërkesës besoj. Mirë e mbyllim dhe këtu hetimin administrativ për këtë kërkesë ankimore dhe tërhiqemi për të marrë vendim. Besoj 10-15 minuta sa të vendosim.

Rifillon Mbledhja

Ora 12:26

Z. I. Rusmali: Atëherë ri kthehemi te Kërkesa Ankimore nr.20, me kërkues subjektin zgjedhor Aleanca Demokracia e Re. KAS-i pasi shqyrtoi në tërësi çështjen, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 41 që të akreditojë vëzhguesit e subjekteve ankuese Aleanca Demokracia e Re, sipas kërkesës që ata kanë depozituar prej tyre në KZAZ.
3. Ky vendim shpallet në faqen zyrtare të Komisionit.
4. Mund të bëhet ankim kundër tij në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr.39

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

23.04.2021
Ora 11:43

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.22, të subjektit ankues
ADR".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto.
- **Parti Politike:** BD, ADR

Z. K. Bele: Pra, vazhdojmë me Kërkesën Ankimore nr. 22, të datës 22. Për të cilën është hedhur shorti dhe relator jam caktuar unë Koli Bele. Kërkesa paraprake nga palët janë të njëjta. Nuk kemi. Besoj sekretari përgjithshëm faktet e relatuara lidhur me këtë çështje janë identike si edhe me çështjet e parashtruara deri më tani.

Z. Y. Merkaj: Po, i njëjti shkak është.

Z. K. Bele: Shoh të njëjtin shkak të refuzimit nga KZAZ-ja nr. 27. Pra, është i njëjti relativim dhe nga ana juaj.

Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Parashtrimi besoj është i ngjashëm duke qenë se shkak është gjithmonë mos respektimi i afatit të pretenduar nga KZAZ-të.

Z. K. Bele: Edhe kërkesat. Kolegët kanë ndonjë pyetje shtesë në këtë rast? Pra, përfundimisht ju e keni të njëjtën kërkesë?

Z. E. Osmani, përfaqësues i Partisë ADR-së: Po i nderuar.

Z. K. Bele: Shfuqizimin, mirë, faleminderit, tërhiqemi për vendim.

Rifillon Mbledhja

Ora 12:27

Z. K. Bele: Vazhdojmë me Kërkesën Ankimore nr.22, të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re. KAS i tërhequr për vendim në përfundim të shqyrtimit të provave, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor ADR.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 27 për akreditimin e vëzhguesve, sipas kërkesës së këtij subjekti zgjedhor.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet dhe publikohet në faqen e KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim kundër tij në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr.40

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

**23.04.2021
Ora 12:29**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.18, të subjektit
ankues LN”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,
Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**

- **Stafi KQZ:** **Y.Merkaj**
- **Parti Politike:** **LN**

Z. E. Çefa: Atëherë, fillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 18, datë 22.04.2021 të paraqitur nga partia politike Lëvizja Për Ndryshim. Kjo senacë do të kryesohet nga unë me cilësinë e relatorit sipas shortit të hedhur ditën e djeshme. Përpara se të fillojmë seancën verifikojmë prezencën e palëve. Është prezente përfaqësuesia e palës ankuese zonja Endira Bushati. Është prezente dhe Administrata e KQZ-së përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Ndonjë kërkesë paraprake zonja Bushati lidhur me trupin e KAS-it?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Jo, nëse mundem të depozitoj provë. Nëse mund ta quajmë një foto të ekranit të thirrjeve telefonike me Sekretarin e KZAZ-së përkatëse?

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. E. Çefa: Dakord, patjetër. I depozitoni tek Administrata. Atëherë, u administruan prova shtesë me kërkesën e subjektit ankues. Anëtarët e KAS ndonjë deklarat për konflikt interesash? Nuk ka. Atëherë mund të vazhdojmë. Shkurtimisht ftoj Sekretarin e Përgjithshëm të bëjë një parashtrim të çështjes përpara se t'ia jap fjalën përfaqësueses së subjektit politik.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 22.04.2021 është paraqitur kërkesa ankimore me ankues Lëvizja Për Ndryshim drejtuar Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 20.04.2021 të KZAZ-së nr. 52, Qarku Elbasan. Si edhe detyrimin për të miratuar listën e vëzhguesëve të partisë Lëvizja Për Ndryshim. Ky ankim është dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i është drejtuar KAS-it. Në arsyetimin e ankimit parashtrohet se vendimi i KZAZ-së nr. 52 nuk është në përputhje me ligjin pasi Partia Lëvizja Për Ndryshim ka të drejtën që të caktojë vëzhgues pasi është subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Është hedhur shorti dhe jemi në seancën e shqyrtimit.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit. Zonja Bushati e keni fjalën. Me mirkofon, ju lutem.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Faleminderit, zoti Çefa. Atëherë, në mënyrë të përmbledhur po them që sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve partia politike Lëvizja Për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në respekt të nenit 6 të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 2 të Shkurt-it 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për akreditimin e vëzhguesëve pranë KZAZ-ve. Deri më sot ne kemi pasur vetëm një problematik në lidhje me KZAZ-n nr. 52 që i takon Qarkut



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Elbasan, konkretisht Librazhdid. Faktet janë të tilla që përfaqësuesi ose më sakt kandidati i subjektit zgjedhor Lëvizja Për Ndryshim ka kontaktuar me Sekretarin, vazhdimisht për hir të së vërtetës, me Sekretarin Lavdim Alliu me detyrën Sekretar i KZAZ-së. Ai në mënyrë të vazhdueshme gjatë komunikimit telefonik i ka thënë hajde nesër. Të nesërmen është shkuar dhe nuk është gjetur. Stafi i kandidatëve të Lëvizjes Për Ndryshim të Qarkut Elbasan nuk ka arritur për ditë të tëra ta kontaktojë. Më në fund në datën 20 është bërë i mundur depozitimi i listës së vëzhguesëve. Siç e shikoni dhe nga vendimi ajo është refuzuar. Por, mund të them që në rrugën, po themi informale është komunikuar që ju keni të drejtë por dhe ne kemi detyrimin që të marrim vendim për shkak të mos respektimit të afatit. Në këto kushte meqenëse në fakt është mos përmbushja e rregullt e detyrës së KZAZ-së. Që gjatë periudhës zgjedhore duhet të jetë e mbledhur gjatë të gjithë ditës. Në kushtet kur është vetë KZAZ që ka penguar subjektin zgjedhor për kryerjen e procedurave të dorëzimit të dokumentacionit përkatës kërkojmë shfuqizimin e vendimit dhe vendosjen e detyrimit të KZAZ-së për pranimin e listës së vëzhguesëve sipas listës që edhe ju e keni bashkangjitur kërkesës ankimore, faleminderit.

Z. E. Çefa: Faleminderit ju. Nga kolegët ndonjë pyetje për përfaqësuesen e subjektit? Atëherë, unë kam një pyetje. Ju administruat prova shtesë?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po.

Z. E. Çefa: A mund të na i përshkruani shkurtimisht ku konsistojnë dhe çfarë janë?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Janë në fakt disa thirrje telefonike të bëra nga kandidati Evald Serreqi që është i renditur i pari në listën shumëemërore të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Lëvizjes Për Ndryshim për Qarkun Elbasan. Është po themi historia e thirrjeve telefonike me Sekretarin e KZAZ-së Lavdim Alliu që daton që nga data 10 Prill e tutje që vërteton komunikimin telefonik me këtë Sekretarë të KZAZ-së. Mund të them që ka qënë i vazhdueshëm komunikimi por nuk gjendeshin në zyrë siç rezulton dhe nga vetë kandidatët e Lëvizjes Për Ndryshim.

Z. E. Çefa: Qartë. Në KZAZ-të e tjera keni paraqitur kërkesa për akreditim?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po, në të gjitha.

Z. E. Çefa: Janë pranuar rregullisht?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po, po të gjitha. Deri më sot, deri në këto momente që po flasim kemi vetëm këtë problem me këtë KZAZ.

Z. E. Çefa: Në çfarë datash? Nëse ju kujtohet i keni paraqitur këto kërkesa? Përgjithësisht jo..

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Jua them unë data. Rreth datës 5, 6..

Z. E. Çefa: E kuptova.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Por, ne kemi ndjekur rrugën që po të shihni kërkesa drejtuar KZAZ-ve i kemi.. është në formën e një formulari. E keni bashkangjitur në kërkesë. Është e firmosur nga vetë Kryetarja e partisë Lëvizja Për Ndryshim dhe i gjithë formulari.. plotësimi i numrit të KZAZ-së është me shkrim dore dhe secili ka të shkruar listën e vëzhguesëve sipas KZAZ-së përkatëse. Mund të ketë nesër, pasnesër ndonjë vendim tjetër të tillë, por deri në momentin që flasim ne vetëm këtë kemi.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit. Atëherë, meqenëse pyetje të tjera nuk ka unë si konkluzion i qëndroj..

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Si konkluzion unë kërkoj shfuqizimin e vendimit të KZAZ-së nr. 52 për mos akreditimin. Pra, që rrëzon kërkesën për akreditim të vëzhguesëve të partisë Lëvizja Për Ndryshim. Si edhe vendosjen e detyrimit për këtë KZAZ që të akreditojë vëzhguesit sipas listës të depozituar nga Lëvizja Për Ndryshim. Nga subjekti zgjedhor Lëvizja Për Ndryshim në respekt të nenit 6 të Kodit Zgjedhor dhe të neneve 5, 6, 7, 8, 9 të udhëzimit nr. 2 të Shkurtit 2021.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit. Atëherë, KAS do të tërhiqet për diskutim dhe për vendim. Për pak minuta do iu njoftojmë që të shpallim vendimin, faleminderit.

Rifillon seanca


Ora 12:41

Z. E. Çefa: Atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 18, datë 22.04.2021 të subjektit Lëvizja Për Ndryshim.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 20.04.2021 të KZAZ-së nr. 52, Qarku Elbasan.
 3. Detyrimin e KZAZ-së nr. 52, Qarku Elbasan për akreditimin e vëzhguesit të partisë Lëvizja Për Ndryshim për vëzhgimin e procesit zgjedhor për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas kërkesës së bërë nga subjekti.
 4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtarë të KQZ-së dhe hyn në fuqi menjëherë.
 5. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor.
- Seanca e deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 41

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr.23 me subjekt ankues
Partia Aleanca Demokracia e Re”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 23, me subjekt Partinë Aleanca Demokracia e Re. Seanca drejtohet nga unë relatori Koli Bele, në këtë kërkesë kemi ankimin e subjektit kundër vendimit nr.15, të KZAZ-së nr.38, Qarku Tiranë. Pala nuk rezulton të jetë prezent. Keni komunikuar?

Z. Y. Merkaj: Po kemi komunikuar dhe është dhënë pëlqimi që shqyrtimi mund të vazhdojë pa prezencën e tyre.

Z. K. Bele: Në rregull, kërkesa nuk kemi. Sekretari i Përgjithshëm të lutem shkurtimisht në lidhje me këtë kërkesë ankimore.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve është depozituar Kërkesa Ankimore nr.23, datë 22.04.2021, ora 18:30. Ankuesi është Partia Aleanca Demokracia e Re. Objekti i ankimit është vendimi nr.15, datë 22.04.2021 i KZAZ-

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.04.2021*

së nr.38, Qarku Tiranë, vendim që ka refuzuar listat e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor. Është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në ligj. Legjitimohet subjekti i kërkesës. I drejtohet KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Është bërë shorti ku u përcaktua relatori dhe tani jemi në seancën e shqyrtimit të kërkesës ankimore, faleminderit!

Z. K. Bele: Ju faleminderit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatojmë që jemi në të njëjtat kushte, kritere si dhe në çështje të tjera të trajtuara në vendimet e mëparshme të ditës së sotme. Kemi një vendim në formën e njoftimit të KZAZ-së nr.38, e cila ka refuzuar kërkesën duke referuar nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimin nr.2 të KQZ-së, në këto kushte.. kolegët pyetje në qoftë se kanë për administratën? Nuk kemi! Atëherë, KAS-i tërhiqet për vendim, pasi përfundon shqyrtimin dhe hetimin administrativ. KAS i konsultuar në vend, vendos: Pranimin e Kërkesës Ankimore nr.23, me subjektin ankues Partia Aleanca Demokracia e Re, ndaj Vendimit nr.15 të KZAZ-së nr.38.

Vendos pranimin e këtij ankimi dhe detyrimin e KZAZ-së të regjistrojë listën e vëzhguesve sipas kërkesës së subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit pesë ditor, pranë Kolegjit Zgjedhor, faleminderit!

Vendimi nr.42

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

